



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.111, datë 30.10.2020

**PËR
RIALOKIMIN E FONDEVE TE PËRFITUARA NË FORMËN E TRANSFERTËS SË
PAKUSHTËZUAR NGA FONDI I RINDËRTIMIT I BUXHETIT TË SHTETIT ME
VLERË 409,081,016 LEKË PËR VITIN 2020**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr.644, datë 03.08.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore në bashkitë Lezhë dhe Durrës”, VKM nr.731, datë 16.09.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e përgatitjes së shesheve të ndërtimit në bashkitë Kurbin, Lezhë dhe Durrës”, VKM nr.775, datë 30.09.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit nga bashkia Durrës, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projektpreventivit dhe rforcimin e hidrovorit të Durrësit”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të Buxhetit”, Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”, Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e rialokimit të fondeve të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar nga fondi i rindërtimit i buxhetit të shtetit me vlerë 409,081,016 lekë për vitin 2020 sipas llogarive ekonomike dhe programeve buxhetore ku do të përdoren, pa ndryshuar emërtimin e produktit dhe kodin e produktit si më poshtë vijon:

Pakësohet :

Min. linjës	Institucioni	Emri i institucionit	Kap.	Prog.	Llog. ekon	Kodi i produktit	Emërtimi i produktit	Buxheti 2020 në lekë
00	2107001	Bashkia Durrës	1	04960	604	90005AA	Hartimi i projektpreventivit dhe rirforcimi i hidrovorit të Durrësit	51,550,000
00	2107001	Bashkia Durrës	1	04960	604	90005AA	Proçesi i transportit të materialeve nga shembja e objekteve të dëmtuara nga tërmeti	76,455,000
00	2107001	Bashkia Durrës	1	04960	604	90005AA	Hartim projekti të ndërhyrjeve rehabilituese përshtatëse	281,076,016
TOTALI								409,081,016

Shtohet:

Min. linjës	Institucioni	Emri i institucionit	Kap.	Prog.	Llog. ekon	Kodi i produktit	Emërtimi i produktit	Buxheti 2020 në lekë
00	2107001	Bashkia Durrës	1	04240	230	90005AA	Hartimi i projektpreventivit dhe rirforcimi i hidrovorit të Durrësit	51,550,000
00	2107001	Bashkia Durrës	1	06140	602	90005AA	Proçesi i transportit të materialeve nga shembja e objekteve të dëmtuara nga tërmeti	76,455,000
00	2107001	Bashkia Durrës	1	06140	231	90005AA	Hartim projekti të ndërhyrjeve rehabilituese përshtatëse	281,076,016
TOTALI								409,081,016

2. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).


KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.10.2020





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 992 / prot.
110.

Durrës, më 04.11 .2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.111 datë 30.10.2020 “Për rialokimin e fondeve të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar nga Fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit me vlerë 409,081,016 lekë për vitin 2020”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

